



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 490, Datë 20.12.2017

“Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 9, 24, (gërma d); 26, 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2017 deri në 31 Dhjetor 2017;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS